



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-15704/20  
Kaçanik, 21.07.2020

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e V (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2020 (Legjislatura e VI-të), mbajtur me 21 Korrik 2020. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve të KK, pjesëmarrës në mbledhje janë 26 anëtarë, ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi ka ofruar dorëheqje. Lënda është dërguar në KQZ, pritet t'i merret mandati nga ky organ- KQZ dhe të bëhet zëvendësimi i saj.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtori e drejtive komunale: Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Festim Neziraj dhe Fatmir Loku, ndërkaq nga zyrtarët e komunës: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Arbnora Kuka.

Nga KDI, mbledhja u monitorua nga Kijani Sallahu.

Nga niveli qendror, mbledhja monitorohet përmes, Teleprezencës nga Gëzim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Për shkak të pandemisë Covid-19, në sallën e Kuvendit të Komunës janë krijuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes me distancë fizike, pajisje më maska mbrojtëse dhe dezinfektues.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesues i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përvendetë të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, kuorumi me u mbajtur mbledhja ekziston, prezantë në mbledhje konstatohet së janë 26 anëtarë, ndërkaq anëtarja Afërdita Shehi ka ofruar dorëheqje, lënda është dërguar në KQZ dhe pritet të bëhet zëvendësimi i saj. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e V (Pestë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2020, data 21 Korrik, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019;
3. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;

4. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU” Bifurkacioni” SHA Ferizaj;
5. Njoftim me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019;
6. Propozim Vendimi për anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 të datës 27.05.2020- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore; dhe
7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës Kaçanik, për miratimin e Deklaratës për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dy pikët e fundit nuk ishin fillimi shtipas ftesës për mbledhje, kështu që të njëjtat janë propozuar më vonë me hynë në rend pune, edhe materiali për këto dy pikë është dërguar më vonë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Lidhur me rendin e punës e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Rendin e Punës në përbërje prej 7 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj; Për vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë Procesverbalin e mbledhjes së Katërt (IV) të Kuvendit të Komunës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin nga mbledhja e IV-të (Katërt) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2020 të datës 30 Qershor 2020 / Lënda: 01Nr. 60/01-13176/20.**

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Kaltrina Tafili**, Duke e parë situatën të cilën ndodhemi për shkak të pandemisë Covid-19, kërkoi nga Shtabi Emergjentë i formuar për menaxhimin e situatës së pandemisë, që për çdo mbledhje t ‘na sjellë Raport me shkrim lidhur me situatën e krijuar në komunën tonë, përgjigja e drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani ka qenë, Kompania që e ka fituar tenderin do të bëjë rimbellen e drunjteve të tharë. Drunjte dekorativ të tharë ka edhe banesa e madhe në Kaçanik. Më intereson të di, a do të rimbilleni drunjte e tharë në këto dy pjesë.

**z. Ekrem Kyçiku**, Në një mbledhje të KK, unë kam bërë pyetje lidhur me drunjë dekorativ të mbjellë të pjesa nga “Ura e Hazirit” deri të “Xhamia e Dëshmorëve”, të cilët drunjë disa janë tharë. Çka do të bëhet me drunjë e tharë ? Pyetjet të cilën e kam bërë atëherë, përgjigja e drejtorit të DSHPE, Ramadush Osmani ka qenë, Kompania që e ka fituar tenderin do të bëjë rimbellen e drunjteve të tharë. Drunjë dekorativ të tharë ka edhe banesa e madhe në Kaçanik. Më intereson të di, a do të rimbilleni drunjë e tharë në këto dy pjesë.

**z. Adnan Reka,**

1. Fillimi i shishet e ujit të pjesës që na është servuar nga shërbimi. Uji i pjesës nga ana ku jemi ulur ne- LVV nuk është i ftohur në krasim shishet e ujit që janë servuar në pjesët tjera të ulëseve të KK. Unë kujtoj se kjo është paedukatë dhe nuk është në rregull në këtë kohë me vapë me na trajtuar në këtë formë.

2. Para një javë dite gati ishte një publikim se DSHPE ka planifikuar reduktimin e shpenzimeve të ndriçimit publik në pjesë të ndryshme të lagjeve dhe lokaliteteve të Kaçanikut. Unë mendoj se këto veprime nuk duhet të merren nga kjo drejtori, por të bëhen sa më tepër ndriçime publike në qytet e vendbanime, sepse terri është tmerr, terri është frikë. Nëse mendon komuna me kursyer buxhetin, komuna ka hapësirë ku mund të kurson buxhet. Unë nuk po i përmendi se ju i dini më mirë se ku mund të kursoni buxhetin.

**z. Selim Reka,** Kam një kërkesë për drejtorin e DAK, drejtori nuk qenka këtu, kështu që pyetjet ia adresoj Kryetarit të Komunës. Situata të cilët ndodhemi për shkak të pandemisë Covid-19, vështirë se mundemi me startuar me mësim në objektet shkollore. Ne duhet me qenë të gatshëm që, nëse nuk startojmë më mësim në shkolla, atëherë të vendosen projektorët në shkolla, arsimtarët tëjenë në shkolla dhe mësimi të zhvillohet nga distanca nga shkollat, sepse mësimi është më efektiv në këtë formë.

**znj. Lirije Luta,** Kam një kërkesë për drejtorin e arsimit që të zhvillojë trajnime për mësimdhënësit të cilët nuk kanë të përfunduar trajnimin e kurrikulës dhe TIK-ut, sepse ne Komisioni i Komitetit për Komunitete kemi zhvilluar disa aktivitete me disa koordinatorë të shkollave, ku ato kanë kërkuar që të mbahen këto trajnime ma urgjent, sepse ende nuk dihet se sa do të zgjas Pandemia e mos të na përcjellin problemet e njëjtë në shtator. Unë e di së, përmes ministrisë së arsimit mund të jetë problem, por kemi edhe forma tjera përmes mësimdhënësve të trajnuar dhe të certifikuar për këto çështje.

**z. Nexhat Loku,** Kam një kërkesë e cila nuk ka të bëjë me ekzekutivin e komunës tonë, por me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës. Banorët e f. Shtrazë, Kotlinë dhe Ivajës që kanë prona përreth pronës së agjencionit, ka filluar kohëve të fundit të pengohen nga agjencionii për hapjen e rrugës, kështu që kemi kërkesë nga ata banorë të këtyre fshatrave që në momentin që Kryetari i Komunës të kontaktojnë me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës, të diskutoj këtë çështje, në mënyrë që mos të dënohen ata qytetarë për hapjen asaj rruge, sepse dënim i është shumë më i madh, sesa hapja e një rruge në gjatësi prej 30 metra në atë pjesë.

**z. Bekim Koxha,**

1. Paraqes shqetësimet e mia për, Degradimin e pyjeve që po bëhet nga prerësit ilegal të pyjeve, me çka gjendja e pyjeve në teren dita ditës po bëhet sa më katastrofale. Ko është një dëshmi të cilën e dimë të gjithë;

2. Janë shqetësuese kyçje ilegale që po bëhen në ujësjellës të disa shtëpive të banimit, pasi që kompania i ka kyçur në ujësjellës, por nuk po kanë ujë, kështu që po mundohen me gjetur forma për me pasur ujë me kyçje ilegale në ujësjellës duke bërë shpime të reja në gypin e ujësjellësit. Nuk e di a është në dijeni drejtori, këto kyçje ilegale, ndërkaq duhet marrë veprime sa më parë për ndaljen e tyre.

3. Të lagjja Koxhaj, Projekti i ndërtimit të trotuarit të rrugës, a do të realizohet ky projekt dhe kur do të filloj ndriçimi publik i kësaj rruge ?

4. Me intereson të di, Çka do të bëhet me mbeturinat e ngurta, a do të merret ndonjë veprim në këtë drejtim, kur dihet fakti se hedhja e mbeturave të ngurta ka bllokuar rrugën e vjetër për në f. Rakaj ?

**z. Shemsedin Luzha,** Kam dy pyetje për Kryetarin e Komunës, Besim Ilazi,

1. Sa duhet me i bërë dëm këtij vendi një shërbyes civil i komunës, për me u zgjedhur punëtori më i mirë i komunës;

2. Sa po e zotëron Kryetari i Komunës territorin e Komunës së Kaçanikut lidhur me menaxhimin e tij në të gjitha fushat.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Lidhur me Kërkesat e ngritura, besoj se drejtoret e drejtive kanë marrë shënime lidhur me kërkesat e ngritura dhe do të jepin përgjigjet me shkrim ashtu siç jemi kuptuar. Atëherë kalojmë në pikët e tjera sipas radhës:

**2. Raporti i punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kjo çështje është dashur me u trajtuar më herët, mirëpo nja dy muaj nuk kemi mbajtur mbledhje për shakat të pandemisë, por nuk na prishë punë të shqyrtohet tani ky raport pune. Anëtarët e këtij komiteti janë prezent në mbledhje, nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë raport pune e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### **VENDIM**

**Me të cilin e Aprovoj Raportin e punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-15000/20.**

**3. Propozim Vendimi për ndryshim plotësimin e vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut;**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, për sqarime të nevojshme më në detaje, në këtë pikë, fjalën e ka drejtori i DSHPE, Ramadush Osmani.

**z. Ramadush Osmani,** Theksoj së me mbylljen e gjirologarisë së Organizatës së veteranëve të luftës (OVL) të UÇK-së, dy shërbime të cilat i kanë kryer kjo shoqatë të subvencionuara nga komuna, jemi munduar me gjetur formën më të mirë për këto dy shërbime, kështu që duhet të ndryshohet vendimi që të kemi mbulesë ligjore. Krahas shërbimeve që i mbulon komuna që kryhen përmes BI që janë 7 shërbime, tek rastet mortore të veteranëve shtohen edhe dy shërbime shtesë: 1. Sigurimi i arkivolit; dhe 2. Sigurimi i flamurit kombëtar, në shumë 175 euro për një rast. Gjithsej për një veteran të luftës janë; 7 shërbimet prej 175 euro si në vendimin e datës 21 janar 2019 + 2 shërbimet të cilat i përmendem në shumë 175 euro. që do të mbulohen me mjetet buxhetore për veteranët e luftës së UÇK-së përmes Bashkësisë Islame(BI). Lidhur me këto ndryshime, do të lidhim marrëveshje edhe me BI.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë Propozim Vendim e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë,

#### **VENDIM**

**Për Ndryshim Plotësimin e Vendimit 01Nr. 104/02-1514/19 të datës 29.01.2019 -Për financimin e shpenzimeve të varrimit për rastet mortore të paraqitura të qytetarët e Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr.07-104/02-15302/20.**

**4.** Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU” Bifurkacioni” SHA Ferizaj;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Këtë çështje e kemi trajtuar edhe në KPF, ka pasur edhe diskutime, Meqë 1 anëtar i këtij komisioni duhet të jetë nga Kuvendi i Komunës, atëherë shkojmë me propozim konkret, duke filluar nga subjekti më i madh politik, PDK.

**z. Nexhat Loku,** Grupi parlamentar i PDK konfirmoj së nuk do të kemi anëtar në këtë komision, kështu që si subjekt me i madh politik tërhiqemi me pasur kandidat në këtë komision.

**z. Ekrem Kyçyku,** Ne subjekti politik i LVV nuk kemi biseduar për këtë çështje, duke menduar se do të përfaqësohet subjekti politik i PDK në këtë komision, kështu që nuk kemi ndonjë emër të caktuar për anëtar të këtij komisioni.

**z. Selim Reka,** Në emër të subjektit politik të LDK, për anëtar të këtij komisioni e propozojmë, Besnik Salihu.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Atëherë propozimin e drejtorisë me propozimin e LDK për anëtarin Besnik Salihu që të përfaqësohet në këtë komision e shtroj në votim për aprovim. Rezultati i votimit është 20 Për, Kundër votë nuk ka, Abstenuan: 6 anëtarë ( 5 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Aprovimin e Propozim Vendimi për formimin e komisionit për identifikimin e parcelave në pronësi të Komunës së Kaçanikut, në të cilat ndodhën puset, rezervuarët e ujit, stacionet e pompimit, ujëmbledhësit dhe objektet tjera infrastrukturore të cilat janë asete të KRU” Bifurkacioni” SHA Ferizaj, në përbërje.**

1. Visar Mulaku, DUKMM,
2. Naim Luzha, KRU’ Bifurkacioni” Njësia operative Kaçanik; dhe
3. Besnik Salihu, anëtar i KK nga LDK-a.

Lënda: 01Nr. 07-104/02-15307/20.

**5.** Njoftim me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ky Raport është publikuar ka kohë në Faqen zyrtare të MAPL, mirëpo ne për shkak të pandemisë nuk kemi pasur mundësi me proceduar më herët në KK. Sipas këtij raporti aktiviteti i Komunës së Kaçanikut është renditur mjaft mirë në vitin 2019. Raportin e harton MAPL e jo ne. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë konstatoj së Kuvendi i Komunës u,

#### Njoftua

**Me Raportin e MAPL për funksionimin e komunave të Republikës së Kosovës, për periudhën Janar-Dhjetor 2019 / Lënda: 01Nr. 02-60/01-15387/20.**

6. Propozim Vendimi për anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 të datës 27.05.2020- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Para se me hapur diskutimin, për sqarime të nevojshme të kësaj pike, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Ukshin Qallaku.

**z. Ukshin Qallaku- Drejtor i DUKMM**, Organi shqyrtues-DBPZH e ka vlerësuar së nuk ka bazë juridike marrja e këtij vendimi dhe na e ka kthyer të njëtin të kundërligjshëm, kështu që është në obligim të organit që e ka marrë vendimin për me anuluar të njëtin.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku**, Kur është diskutuar marrja e këtij vendimi, unë kam thënë së i njëjti bien në kundërshtim me dispozitat në fuqi të akteve që e rregullojnë ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, kështu që në bazë të vendimit të MAPL po shihet se ne (LVV) kemi pasur të drejtë.

**z. Bekim Koxha**, Edhe ne subjekti politik NISMA, kur u shqyrtua kjo çështje kemi qenë kundër dhe tani po vërtetohet se kemi pasur të drejtë.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Propozimin për Anulimin e këtij vendimi e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për Anulimin e Vendimit Paraprak 01Nr. 06-350/01-9350/20 të datës 27.05.2020- për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore / Lënda: 01Nr. 350/02-16206/20.**

7. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës Kaçanik, për miratimin e Deklaratës për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Kjo çështje është ngritur edhe në KPF dhe kjo trupë punuese u pajtua që kjo deklaratë t'i adresohet Kuvendit të Komunës. Fillimisht kërkoj nga shefi i GP të PDK të lexoj Deklaratën e iniciuar nga ky subjekt politik.

**z. Nexhat Luku**, E lexoj Deklaratës për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. në përbërje prej 8 pikave, të iniciuar nga GP i PDK të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka në këtë pikë e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku**, Lufta e UÇK për liri e pavarësi ka qenë luftë e drejtë dhe e pastër. Qëndrimi i LVV është i njohur. Gjykata Speciale është një e keqe e madhe që i bëhet shtetit të Kosovës. Gjykata Speciale në vend së merret me krimet që i ka bërë Serbia në Kosovë, po merret me UÇK-në. E marrim vetëm shembull, Komunën e Kaçanikut, dëmet që i ka bërë Serbia në këtë vend kundër popullatës së pafajshme, janë dëme shumë të mëdha. Deklarata si e tillë është e mirë, por jo të përmenden emrat e përvëçëm në të. Votimi i gjykatës speciale

nuk ka qenë në rregull nga ana e atyre që e votuan formimin e saj dhe të njëjtit mbajnë përgjegjësi për themelimin e saj.

**z. Bekim Koxha,** Këtë deklaratë e mbështesim, sepse lufta e UÇK ka qenë e drejtë dhe e pastër. Vet shkuarja e krerëve të shtetin të Kosovës në këtë gjykatë, për ne është e dëmshme, sepse e dëmton shtetin e Kosovës dhe vlerat e luftës së UÇK-së. Edhe NISMA ka qenë kundër krijimit të Gjykatës Speciale, sepse kjo gjykatë i dëmton vlerat e ushtarëve dhe vlerat e luftës në përgjithësi të UÇK. Ne subjekti politik i NISMA konfirmoj së do të mbështetim Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.

**z. Shemsedin Luzha,** Në emër të Grupit Parlamentar të Pavarur, konfirmoj së jemi për mbështetjen e Deklaratës për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.

**z. Selim Reka,** Edhe pse kjo deklaratë nuk ka ndonjë peshë juridike, por më tepër është një formë që të solidarizohemi me mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së, ne subjekti politik i LDK do të mbështetim këtë deklaratë.

**z. Agim Mani,** Unë kam qenë pjesë e UÇK-së dhe e ndiej obligim moral të reagoj për çdo padrejtësi ndaj tyre dhe të reagoj dhe t'i mbroj siç i kemi mbrojtur në kohërat më të vështira. Çmoj lartë vlerat e UÇK dhe ndihem krenar që pata mundësi me kryer këtë obligim dhe sakrificë. UÇK ka bërë luftë të drejtë dhe të pastër në mbrojtje të qytetarëve të Kosovës për çlirimin e saj. Shqetësimi im është, për derisa vlerat e UÇK nuk mbrohen me ligj përakuza. liqime dhe shantazhe, kjo mund të na përcjellë edhe neve të gjithë pjesëtarëve të tjerë të UÇK. Formimi i Gjykatës Speciale është gabim, së po vë në mëdyshje luftën e drejtë dhe të pastër të UÇK në veçanti dhe jo kriminelët serb të cilët bënë krimë në Kosovë. Sa i përket deklaratës së iniciuar nga GP i PDK për ngritjen e aktakuzave të pjesëtarëve të UÇK Hashim Thaqi dhe Kadri Veselit, edhe unë e quaj të paprecedentë dhe jashtë normave të juridikacionit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, sigurisht së jam kundër ngritjes se aktakuzave kundër çlirimtarëve, për arsy se lufta çlirimtare ka qenë e drejtë dhe asnjëherë mos të kontestohet pastërtia e saj. Unë jo vetëm që kundërshtoj aktakuzën e ngritur ndaj pjesëtarëve të UÇK, por kundërshtoj edhe gjykatën e njëanshme që ka për qëllim një etnie, në këtë rast vetëm çlirimtarët e UÇK. Deklarata e iniciuar nga GP i PDK e kundërshton vetëm zyrën e prokurorisë së specializuar dhe nuk e kundërshton gjykatën speciale në tërësi si të njëanshme e cila merret vetëm më ushtarët e UÇK dhe nuk merret me krimet serbe që i bënë në Kosovë. Unë kërkoj që pos aktakuzave të ngritura nga zyra e prokurorisë speciale, të kundërshtohet edhe funksionimi i gjykatës speciale në tërësi, të cilën në asnjë pikë të deklaratës së juaj nuk kundërshtohet gjykata speciale në tërësi, vetëm zyrat e prokurorisë speciale që ngritur aktakuzë për dy pjesëtarë të UÇK, ndërsa çlirimtarët tjerë të mbresin nën mëshirën e gjykatës speciale. Kjo deklaratë e juaja e përgjysmuar, sepse i kundërshtohen vetëm dhomat e specializuara, kur dihet së funksionojnë në kuadër të gjykatës speciale, më bënë të pasigurt të votoj deklaratën për mbrojtjen e çlirimtarëve dhe vlerat e UÇK.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Unë iu shprehi falënderime të gjithëve që u solidarizuat me këtë deklaratë, Grupi parlamentar i PDK nuk i ka dhënë kahe politike deklaratës. Presidenti i Kosovës nuk është post politik, presidenti është i të gjithëve. Forma e adresimit të aktakuzës është e paprecedentë në sistemin gjyqësor deri më tanë, për shkak së në procedurat juridike nuk mund të konfirmohet aktakuza pa u konfirmuar nga gjykata, që na bënë më kuptuar së kjo më tepër është një lojë politike, sesa për krimë kundër njerëzimit, sepse të gjithë e dimë dhe e secili ushtar i UÇK e thotë me mburrje atë që ka qenë ushtar të UÇK-së, sepse lufta e UÇK ishte luftë për çlirim dhe nuk ka pasur asnjë rrugë tjetër për këtë çështje. Themelimin e

Gjykatës Speciale nuk e kontestojmë dhe nuk frikësohemi për gjykatën speciale, sepse askush nuk duhet të frikësohemi për gjërat që nuk i kemi bërë dhe çdo herë kur të jetë nevoja duhet të paraqitet para se cilës gjykatë dhe të tregojmë pastërtinë e luftës së UÇK-së. Po, mënyra e adresimit të akuzave pa konfirmim të aktakuzës nga gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës është e paprecedentë deri tani dhe kjo është pikërisht lojë politike e strukturave në që ne i konsiderojmë së janë me prapavija politike. Me vjen mirë që të gjithë e përkrahni thelbin-esencën e kësaj deklarate, pastaj secili i ka direktivat e veta se ku mendon së është keq apo mirë, sido që të jetë, asnjëherë asnjë ushtar i UÇK nuk i frikësohemi asnjë gjykate, mos të bëhem ne më të dashur, sepse shumë deputet që e kanë miratuar themelimin e gjykatës speciale dhe mos mendoni se ata nuk kanë menduar edhe për vetën e tyre, sepse shumë nga ta janë intervistuar nga ajo gjykatë, por kjo ka qenë një proces i Bashkësisë Ndërkombëtare. Kosova gjithmonë ka me ecë me hapa me BE dhe Amerikën pa iu frikësuar asnjëherë veprimtarisë tonë që kemi bërë e që mendojmë së ka qenë jashtëzakonisht e drejtë.

**z. Adnan Reka,** Unë pajtohem më tepër së 90 % të tekstit të deklaratës, ndërkaq nuk pajtohem të pika 2 dhe të pika 5. E para, unë nuk pajtohem të emrat e përveçëm, sepse nuk mundet të jetë ndonjë sinonim i UÇK. Unë nuk di për akuzat e tyre, por atë që e di unë është së, lufta e UÇK ka qenë luftë e pastër dhe e drejtë, luftë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Do të ishte mirë sikur të kishim Ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së që të rregullonte këto probleme, sepse deklaratat pa bazë juridike, unë nuk e di së çfarë peshe mund të kenë.

**z. Hajredin Luta,** Lufta e UÇK ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës. Unë i dëgjova të gjitha pikat e deklaratës të cilat u lexuan këtu, dhe nuk pashtë së ka diçka të keqe në deklaratë. Emrat e përveçëm kanë të bëjnë më eprorët e luftës së UÇK, dhe nëse këta dënohen, atëherë do të dënohem i gjithë ne që kemi qenë ushtar të UÇK. Lufta e UÇK ishte luftë e pastër për çlirim e pavarësi të Kosovës. Vet fakti tregon kur forcat e NATO-s e dhe Amerika e përkrahin luftën e UÇK-së për largimin e regjimit serb nga Kosova. Unë nuk kam diçka tjetër me shtuar, vetëm së konfirmoj së e përkrahim Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë Deklaratën e iniciuar nga Grupi parlamentar i PDK-së për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me 20 votë Për, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 6 anëtarë- (5 anëtarët nga LVV dhe Ekrem Raka). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës

#### MIRATOJ

**Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës / Lënda: 01Nr.60/02-15987/20.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:40. Mbledhjen e konstatoj të përfunduar Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët (26) sa ishin prezentë në fillim të mbledhjes.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Mërseli

**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
(të zgjedhur në votimet e datës 22 Totor 207);**

**nga Mbledhja e V –të (Pestë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për  
vitin 2020, mbajtur me 21 Korrik 2020;**

1. Kemal Mërseli.....,
2. Hamid Guri.....,
3. Ahmet Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,
5. Besim Vishi,.....,
6. Sali Malsiu.....,
7. Lirije Shurdhani.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,
9. Lirije Luta.....,
10. Vlora Dalloshi.....,
11. Nexhat Loku .....,
12. Agim Mani.....,
13. Adnan Reka.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,
16. Kaltrina Tafili .....,
17. Selim Reka.....,
18. Besnik Salihu,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,
21. Shemsedin Luzha.....,
22. Albana Troni.....,
23. Afërdita Shehi,..... Dorëheqje
24. Hajredin Luta.....,
25. Hafize Sallahi .....,
26. Bekim Koxha.....,
27. Ekrem Raka,.....,



Data	16.07.20	Vendi	KAÇANIK
Nr. e urit		Nr. e marrëveshjes	
01	60/02 - 03267 - 1		

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës në Kuvendin e Komunës Kaçanik i propozon Kuvendit të Komunës miratimin e Deklaratës për Mbrojtjen e Vlerave të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës:

### DEKLARATË

1. Konfirmojmë qëndrimin tonë dhe bindjen e paluhatshme se lufta mbrojtëse e qytetarëve të Kosovës, e udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, dhe e përkrahur nga forcat e NATO-së, ishte luftë e drejtë dhe e pastër për çlirimin e Kosovës kundër regjimit gjenocidal të Slobodan Milosheviqit, forcave ushtarakë, policore e paramilitare të Serbisë në Kosovë.
2. Vlerësojmë të paprecedent veprimin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të publikuar njoftimin përnjë aktakuzë të pakonfirmuar nga Gjyqtari i procedurës paraprake ndaj dy prej liderëve kryesorë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli.
3. Shprehim shqetësimin se ky veprim i Zyrës së Prokurorit të Specializuar përbën edhe shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe është në kundërshtim të plotë me parimin themelor të drejtësisë, atë të prezumimit të pafajësisë.
4. Ritheksojmë se lufta mbrojtëse e UÇK-së ka qenë e drejtë dhe do të mbetet përherë e tillë. Ajo nuk mund të njolloset asnjëherë. Bashkësia ndërkombëtare duhet ta çmojë lart bashkëpunimin e institucioneve kosovare dhe ish-pjesëtarëve të UÇK-së me institucionet e drejtësisë ndërkombëtare përgjatë këtyre njëzet vjetëve, përfshirë Dhomat e Specializuara. Në gjithë këto procese është dëshmuar pastërtia e luftës së popullit shqiptar përliri e pavarësi.
5. Njohim dhe vlerësojmë lart sakrificën, angazhimin dhe kontributin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetur nga NATO, e të udhëhequr nga SHBA-të dhe aleatet e saj, përlirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Solidarizohemi dhe shprehim njëzëri mbështetjen e plotë përliri z. Hashim Thaçi dhe z. Kadri Veseli, të cilët janë ndër themeluesit dhe udhëheqësit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe shprehim besimin e palëkundur përliri e tyre.
6. I konsiderojmë përpjekje të padrejta dhe të rrezikshme, por të parealizueshme, tendencat përliri e kriminalizuar luftën e drejtë dhe të lavdishme të popullit të Kosovës përliri dhe pavarësi. Refuzojmë çfarëdo përpjekje përliri etiketuar UÇK-në si agresore;
7. E vërteta përliri historinë e popullit shqiptar nuk mund të deformohet dhe as të tjetërsohet nga ata që pretendojnë përliri barazuar viktimat me kryesit e krimeve serbe. Kosovën nuk mund ta dobësojë askush dhe të ardhmen e saj euroatlantike nuk mund ta devijojë dhe as ta ndalë asnjë përpjekje.
8. Si përfaqësues të qytetarëve, të zgjedhur në mënyrë demokratike, bëjmë thirrje përliri unitet mes njerëzve dhe bashkërendim të angazhimeve ndërmjet partive politike përliri ruajtur shtetin e Kosovës, vlerat e luftës dhe pastërtinë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së

Shefi i grupit, Nexhat Loku

**Lista e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për Deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

1.Kemal Mërseli

Kemal Mërseli

2.Nexhat Loku

Nexhat Loku

3.Hamid Guri

Hamid Guri

4.Ahmet Luma

Ahmet Luma

5.Kadri Krivenjeva

Kadri Krivenjeva

6.Besim Vishi

Besim Vishi

7.Sali Malsiu

Sali Malsiu

8.Lirije Shurdhani – Dema

Lirije Shurdhani

9.Pranverë Loku-Zharku

Pranverë Loku-Zharku

10.Lirije Luta

Lirije Luta

11.Vlora Dalloshi

Vlora Dalloshi



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF  
KOSOVO



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik/Municipality of Kaçanik

Zyra e Kryetarit

Për: Anëtarët e kuvendit komunal /z.Shemsedin Luzha

Nga: Zyra e Kryetarit

Lënda: Përgjigje në kërkesë

Të nderuar, më lejoni t'i përgjigjем pyetjeve/kërkesave të parashtruar nga anëtarët e kuvendit të komunës së Kaçanikut, të cilat i janë adresuar Kryetarit të komunës:

z.Shemsedin Luzha:

1. Sa duhet me i bërë dëm këtij vendi një shërbyes civil i komunës, për me u zgjedhur punëtori më i mirë i komunës?

Vlerësimin e Shërbyesve Civil e kryejnë Drejtoret e Drejtoreve Komunale. Ky vlerësim përfshinë aktivitetet e tyre sipas detyrave dhe obligimeve vjetore. Realizimi i këtyre objektivave rezulton me suksesin e shërbyesit civil.

2. Sa po e zotëron Kryetari i Komunës territorin e Komunës së Kaçanikut lidhur me menaxhimin e tij në të gjitha fushat?

Kryetari i Komunës menaxhon të gjitha situatat në kuadër të kompetencave të tij të cilat bazohen në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës.



Kryetari i komunës:


Besim Ilazi



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**Komuna Kaçanik**  
Opština Kaçanik  
Municipality Kaçanik

DATË/A:	07.08.2020
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Delegatët e Kuvendit Komunal
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Fatmir Luku, Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në pytjen e deputetit z.Bekim Kokxa lidhur me gjendjen e pyjeve, dhe degradimin e pyjeve që po bëhen nga prerësit ilegal.

Përmes kësaj shkresë ju informojmë lidhur me aktivitetet e ndërmarra për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale. Sa i përket mbrojtjes së pyjeve për pjesën që ne jemi përgjegjës për mbrojtjen e pyjeve, ne si drejtori fillimisht kemi rritur numrin e punëtorëve ( 2 roje pylli) me kontratë në vepër për gjashtë muaj, me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbrojtjen e pyjeve, sidhe kemi fillu përmes përbarsut procedurat për kompenzimin e damit të shkaktuar nga prerësit ilegal, të cilët janë denuar me vendim të prerë të gjykatës.

Gjithashtu në bashkëpunim me policinë dhe rojet e pyllit kemi organizuar kontrolla të përbashkëta në terren, si dhe kemi bërë konfiskime të masës drusore të cilat i kemi sjellë në autoparkun e shoqatës së Invalidëve të Luftës, si dhe janë ngritur fletëparaqitje personave që kanë kryer kundërvatje me transportim ilegal të drunve, si dhe konfiskimi i masës drusore në njësi menagjuse që menagjon Drejtoria e BZHRP-së.

Vlenë të theksohet e dhe shërbimi që është bërë në pyjet private duke fillu që nga aplikimi, vulosja, dhe transportimi i mases drusore në mënyrë legale.

Ne si drejtori jemi të shqetsuar për dukurin e shumtuar të pjesës së parkut nacional të sharri,kemi pasur takime të përbashkëta të cilat i ka organizuar Kryetari i Komunës z.Besim Ilazi me institucionet përgjegjëse: Policia e Kosovës,Prokuroria,Gjykata si dhe drejtorin e Parkut Kombëtar si dhe komunitetin lokal,ku i kemi trajtu problemin bashkarisht se si të ballafaqomi me këtë situatë. Sa i përket pjesës së Parkut Kombëtar Sharri ne edhe në njoftimet e mëhershme ju kemi informuar se përgjegjësia është e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në kuadër të së cilës funksionon Drejtoria e Parkut, me seli në Prizren.

Sa i përket pjesës së pyjeve në Parkun Kombëtar Sharri, ne në Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor vazhdimesht kemi përcjellë shkresa përti informuar dhe ngritur shqetësimet tonë, për gjendjen e krijuar në atë pjesë të pyjeve-pjesë e territorit të Komunës sonë.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Kaçanik, 07.08.2020

Për: Anëtarët e Kuvendit/  
z. Ekrem Kyçiku  
z. Adnan Reka,  
z. Bekim Koxha

### Lënda: PËRGJIGJE

Tënderuar,

Më lejon t'ju përgjigjëm dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 21.07.2020, të cilat ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.

**z. Ekrem Kyçiku**, Në një mbledhje të KK, unë kam bërë pyetje lidhur me drunjë dekorativ të mbjellë të pjesa nga "Ura e Hazirit" deri të "Xhamia e Dëshmorëve", të cilët drunjët disa janë tharë. Çka do të bëhet me drunjët e tharë? Pyetjet të cilën e kam bërë atëherë, përgjigja e drejtorisë të DSHPE, Ramadush Osmani ka qenë, Kompania që e ka fituar tenderin do të bëjë rimbjellen e drunjëve të tharë. Drunjët dekorativ të tharë ka edhe banesa e madhe në Kaçanik. Më intereson t'di, a do të rimbilleni drunjët e tharë në këto dy pjesë.

*-Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, përmes Zyrës së Prokurimit, si autoritet kontraktues, ka njoftuar me kohë kompaninë punëkryese të punimeve te hapësira gjelbëruese dhe parkingjeve pranë banesës P+8, për zëvendësimin e drunjëve dekorativ (të tharë) me drunjë të rinjë. Mbjellja e drunjëve të rinj do të bëhet në kohën përshtatshme atmosferike të sygjeruara nga drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë, kurse rrëth drunjëve të tharë nga "Ura e Hazirit" deri te "Xhamia e Dëshmorëve", ne kemi njoftuar edhe më herët organin mykëqyrës të këtij projekti për zëvendësimin e drunjëve dekorativ të tharë ngase ky projekt është financuar dhe implementuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit (ish MMPH-ja), sepse në këto raste komuna është vetëm në cilësin monitoruese të projektit.*

**z. Adnan Reka**, Para një jayë dite gati ishte një publikim se DSHPE ka planifikuar reduktimin e shpenzimeve të ndriçimit publik në pjesë të ndryshme të lagjeve dhe lokaletave të Kaçanikut. Unë mendoj se këto veprime nuk duhet të merren nga kjo drejtori, por të bëhen sa më tepër ndriçime publike në qytet e vendbanime, sepse terri është tmerr, terri është frikë. Nëse mendon komuna me kursyer buxhetin, komuna ka hapësirë ku mund të kursen buxhet. Unë nuk po i përmendi se ju i dini më mirë se ku mund të kurseni buxhetin.

*-Drejtoria është duke ndërtuar në vazhdimësi rrjete të reja të ndriçimit publik dhe planifikon edhe në të ardhmën të ndërtoj rrjete tjera bazuar në arsyeshmërinë e investimeve. Kostoja në rritje e faturës mujore të shpenzimeve të energjisë elektrike për rrjetet aktuale dhe planifikimeve të investimeve të reja ka shtyrë në analizimin e masave për kursimin e mundshëm dhe reduktimin e kohës së ndriçimit të rrugëve sekondare në zonën urbane dhe rrugëve kryesore në fshatra. Në këtë reduktim nuk përfshihen rrugët "Agim Bajrami", "Ismail Raka", "Skenderbeu", "Idriz Seferi", "Qamil Hazi", "Vëllezërit Çaka" dhe "Sali Bajra".*

**z. Bekim Koxha.** Janë shqetësuese kyçje ilegale që po bëhen në ujësjellës të disa shtëpive të banimit, pasi që kompania i ka kyçur në ujësjellës, por nuk po kanë ujë, kështu që po mundohen me gjetur forma përmes pasur ujë me kyçje ilegale në ujësjellës duke bërë shpime të reja në gypin e ujësjellësit. Nuk e di a është në dijeni drejtori, këto kyçje ilegale, ndërkaq duhet marrë veprime sa më parë përmes ndaljen e tyre.


3. Të lagjja Koxhaj, Projekti i ndërtimit të trotuarit të rrugës, a do të realizohet ky projekt dhe kur do të filloj ndriçimi publik i kësaj rruge?

*-Ju informojmë se jemi në pritje të dokumentacionit final të pranimit teknik të rrjetit të ujësjellësit për lokalitetet Dubravë-Rekë-Doganaj-Elezaj-Koxhaj dhe Nikaj nga ministria, si financuese dhe mbikëqyrëse e projektit. Pas pranimit teknik të projektit, rrjeti i ujësjellësit do të menaxhohet nga KRU "Bifurkacioni"-njësia operative në Kaçanik. Të gjitha kyqjet e evintuara ilegale apo ndërhyrjet e paautorizuara në rrjet do të ndërprenen dhe ndaj personave do të merret inspekksioni komunal.*

*-Projekti "Asfaltimi i rrugës në fshatin Koxhaj" është i koduar në listën e investimeve kapitale 2020-2021, ka të planifikuar 50,000,00€ përmes vitit 2021. Në kuadër të projektit është i planifikuar edhe ndërtimi i trotuarit dhe rrjetit të ndriçimit publik.*

Ju falenderojmë përmes bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,



Ramadani Osmani  
Drejtor i DSHPE-s